REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË  - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës: | 2019:135177 |
| Datë: | 12.11.2024 |
| Numri i dokumentit: | 06439477 |

**C.nr.851/2024**

**GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË DEÇAN** Departamenti i Përgjithshëm, civil o-juridike i shkallës së pare më gjyqtarin Bekim Avdimetaj, në kontestin e paditëses E. G. nga Juniku te cilën e përfaqëson me autorizim avokati I. H. nga P. kundër te paditurës K. S. “S...” për  shpenzimet e procedurës kontesti morë  vlera e kontestit 2263.00 euro gjykata pas përfundimit te seancës te shqyrtimit kryesore publike me date 23.10.2024 ne prani te autorizuarit te padis ës e ne mungesë te paditurës te përpiluar me date 05.11.2024 mure këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET** si e bazuar  kërkesëpadia e paditëses E.G., nga J., te cilën e përfaqëson me autorizim avokati I. H., nga P.

**II. DETYROHET** e paditura K.S “S...” me seli ne P., qe paditëses E. G., nga J.,  për shpenzimet e procedurës kontesti morë te ja paguan dhe atë :

-Për përpilimin e padis nga i autorizuari i paditësit në shumen prej  156.00 euro.
-Për përfaqësim te autorizuarit te paditësit për  5 seanca 5x270.40 ne shume prej 1.350.00 euro .
-Për një seancë te shtyrë  ne shumen prej 135.00 euro
-Për 2 ekspertiza te dhen nga mjeket eksperte  2x100 ne shume prej 200.00 euro
 -Për taks gjyqësore për padi të paditësit  ne shumen prej 100.00 euro
-Për precizi m te kërkesëpadisë te paditëses  te bere nga i autorizuari paditëses ne shumen prej 135.00 euro
-Për precizi m  te kërkesëpadisë te bere nga i autorizuari paditëses sa i përket shpenzimeve te procedurës kontesti morë  ne shumen prej 135.00 euro
Gjithsejtë ne shumen e përgjithshme prej 2.213.00 euro, të gjitha këto ne afte prej 15 ditëve nga dita e marrjes te këtij aktgjykimi e nen kërcenim te përmbarimit .

**A r s y e t i m**

Paditësja  E. G., nga J. te cilën e përfaqëson me autorizim avokati I. H., nga P. ka paraqitur padi ne ketë gjykate kundër te paditurës K.S “S...” me seli ne P., për  shpenzimet e procedurës kontesti morë .

## Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës

Neni 29 i Ligjit të Procedurës Kontesti more parasheh, në procedurë kontesti morë gjykatat gjykojnë brenda kufijve të kompetencës së vet lëndore të caktuar me ligj.

## Pretendimet e te autorizuarve te palëve ndërgjyqësve

I autorizuari i paditëses av. I. H. gjate seancës te shqyrtimit kryesore dhe ne fjalën e tij përfundimtare me date 23.10.2024 ka deklaruar se mbete pran kërkesëpadisë te padis ës dhe parashtrese te dorëzuar ne gjykate me datën 15.04.2024 te precizi mit te kërkesëpadisë sa i përket shpenzimeve te procedurës dhe atë :

-Për përpilimin e padis nga i autorizuari i paditësit në shumen prej 156.00 euro.
-Për përfaqësim te autorizuarit te paditësit për 5 seanca gjyqësore me date 30.07.2019,16.12.2019, 23.01.2020, 02.04.2024,23.10.2024 5x270 5x270.40 ne shume prej 1.352.00 euro .
-Për një seancë te shtyrë 24.10.2019 ne shumen prej 135.00 euro
-Për 2 ekspertiza te dhen nga mjeket eksperte 2x100 ne shume prej 200.00 euro
-Për taks gjyqësore për padi të paditësit ne shumen prej 100.00 euro
-Për precizi m te kërkesëpadisë te padis ës te bere nga i autorizuari padis ës te dorëzuar ne gjykate me shkrim me datën 06.01.2020 ne shumen prej 135.00 euro
-Për precizi m te kërkesëpadisë te bere nga i autorizuari padis ës sa i përket shpenzimeve te procedurës kontesti morë te dorëzuar ne gjykate me datën 15.04.2024 ne shumen prej 135.00 euro
Gjithsejtë ne shumen e përgjithshme prej 2.213.00 euro
Këto shpenzime te specifikuar nga i autorizuari i padis ës sipas të Tarifës së Odes se Avokatëve dorëzuar gjykatës me shkrim me datën 15.04.2024.

Neni 449. par.1 Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor. par.2 Shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave të tjerë të cilëve ligji u jep të drejtën e shpërblimit.

Neni 463 par.1 Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën. par.2 Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t'i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës te ligjit Ligjit Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore

Ndërsa i autorizuari i padis ës i lartshënuar gjate seancës te shqyrtimit kryesore me date 23.10.2024 e ka tërheq padinë e padis ës sa i përket terapisë fizika lë te padis ës pasi qe nuk ka prova për shpenzimet e kësaj natyre .

Gjykata gjate seancës te shqyrtimit kryesore me date 23.10.2024 e ka aprovuar propozimin e te autorizuarit te padis ës për tërheqjen e padis te padis ës sa i përket terapisë fizika lë si te pa bazuar me prova materiale

Gjykata e ka ftuar me ftes ne mënyre te rregullte te paditurën K.S "S..." me seli ne P., për seancën e shqyrtimit kryesore te caktuar nga gjykata me datën 23.10.2024 dhe nga flet kthesa e kthyer ne gjykate me datën 25.09.2024 është e nënshkruar qe ka pranuar dhe për arsyen e mosardhjes



2024:201811

nuk e ka njoftuar gjykatën me ndonjë parashtresë me shkrim, andaj gjykata ka vepruar ne kuptim te nenit 151, 423 par. 4 te LPK.

## Administrimi i provave gjate seancës te shqyrtimit kryesor

Gjykata gjatë seancës te shqyrtimit kryesore ka bere administrimin e provave

- Lexohet aktgjykimi i Gjykatës se Apelit te Kosovës me date AC.nr.649/21 i marre me date 01.11.2023
- Lexohet padia me gjitha shkresat e saj me numër Cnr.358/2017.
- Lexohet parashtresa e te autorizuarit te padis ës te dorëzuar ne gjykate me datën 15.04.2024 te precizi mit te kërkesëpadisë te padis ës sa i përket shpenzimeve te procedurës .

Te cilave provave të lartshënuar qe gjenden ne shkresat e lendes gjykata ja ka falur besimin.

## Dispozitat ligjore

Pasi që gjykata bëri vlerësimit te secilës provë veç e veç, dhe të gjithave atyre se bashku e dhe nga kjo gjendje e vërtetuar faktike si me larte ne mënyre te padyshimte e aprovoj kërkesëpadinë e paditëses si te bazuar duke mbështetur ne nenin 449. par.1 Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor. par.2 Shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave të tjerë të cilëve ligji u jep të drejtën e shpërblimit. Neni 463 par.1 Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën. par.2 Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t'i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës te Ligjit Nr. 03/L-006 për procedurën kontesti morë duke vendosur si ne piken **I** dhe **II** te dispozitivit të këtij aktgjykimi. .

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi

**NGA GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA DEÇAN.**

**G J Y Q T A R I**
**Bekim Avdimetaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh Gjykatës së Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj gjykate .



2024:201811